


REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇANI - OPSTINA DEÇANI



Ne bazë të nenit 17 shkronja (f) dhe (n), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040. Nenit 6, Nenit 7 paragrafi (8), 12 paragrafi (2), neni 15, 17, 25 dhe 32 të Ligjit për Transport Rrugor, Nr 04/L-179 dhe në mbështetje të nenit 25 pika 1. Të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur më dt.26.09.2014, miratoi këtë:

RREGULLORE

Për Transportin Urban dhe Urban Periferik të Udhëtarëve

Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore, rregullohet mënyra e transportit të udhëtarëve brenda zonës urbane dhe urbane periferike në Komunën e Deçanit. Përgjegjësitë e komunës për transportin publik të udhëtarëve, Transporti i udhëtarëve me automjet mbi 8+1 dhe me auto-taksi, marrja dhe humbja e licencimit dhe rendit të udhëtimit, transporti i veçantë i udhëtarëve.

Përkufizime

Neni 2

Rrugë publike - një sipërfaqe me rëndësi të përgjithshme për komunikacion, në të cilën mund të lëvizë çdo kush me kushte të caktuara me ligj dhe të cilën organi kompetent e ka shpall rrugë publike;

Operator-taksi - veprimtari e transportit të udhëtarëve e cila ushtrohet nga personat fizik dhe juridik;

Stacion i autobusëve - objekti me infrastrukturën përcjellëse të licencuar nga Ministria me qëllim të ofrimit të shërbime për operatorët e transportit rrugor të udhëtarëve dhe udhëtarët;

Vend-ndalje - sipërfaqe e ndërtuar dhe të shënuar posaçërisht, e caktuar për ndaljen e autobusëve e që mundëson hyrjen, përkatësisht daljen e sigurt të udhëtarëve dhe bagazheve;

Itinerar - akti i cili përcakton kahun e lëvizjes së automjeteve në linjë;

Lëshues i licencës - organi i cili sipas dispozitave të këtij ligji është kompetent për lëshimin e licencës;

Certifikatë e automjetit - dokument të cilin e lëshon organi kompetent për çdo automjet veç e veç dhe i cili përmban të dhënat për: lëshuesin e organit kompetent, operatorin e transportit, numrin e licencës, përkatësisht lejes, shenjën (targat) e regjistrimit, markën tipin, numrin e

shasisë së automjetit, kapacitetin bartës, llojin e transportit që mund të kryhet, datën e lëshimit të certifikatës, vulën dhe nënshkrimin;

Operator i transportit rrugor të udhëtareve - veprimtari e çdo operatori që vepron me anë të mjeteve motorike që janë të përshtatshme për bartjen e më shumë se nëntë personave, përfshirë edhe vozitësin, dhe të destinuara për këtë qëllim, shërbimet e transportit të pasagjerëve për publik ose për kategori të veçanta të përdoruesit në këmbim të pagesës nga personi i transportuar ose nga organizatori transportit

Transport publik - transport të cilin në kushte të njëjta mund ta shfrytëzojnë të gjithë shfrytëzuesit e shërbimeve të transportit

Transport publik linjor i udhëtarëve - transporti i cili kryhet në relacionet e caktuara dhe sipas rendit të udhëtimit, çmimeve dhe kushteve të përgjithshme të transportit të përcaktuara paraprakisht

Licencë - akti me të cilin operatorit të transportit rrugor i lejohet të ushtrohet veprimtaria e transportit rrugor të udhëtarëve ose mallrave, stacionet e autobusëve dhe terminaleve të mallrave

Linjë - relacioni ose tërësia e relacioneve të kryerjes së transportit në komunikacionin rrugor, prej stacionit fillestar deri në stacionin, përkatësisht deri në vend-ndaljen përfundimtare, në të cilën transportohen udhëtarët sipas rendit të udhëtimit të regjistruar dhe të publikuar me një ose me më shumë nisje

Linjë urbane - linja e cila i lidh dy e më tepër stacione, gjegjësisht vend ndalje brenda kufijve urban të një Komune – qyteti

Linjë urbane-periferike - linjë e cila i lidh dy e më tepër stacione, gjegjësisht vend ndalje brenda territorit të një Komune

Linjë udhëtarësh - linjë në të cilën kryhet transporti ndërmjet stacionit fillestar dhe përfundimtar, përkatësisht vend ndaljes së autobusëve me ndalje të detyrueshme në të gjitha stacionet, përkatësisht vend ndaljet e autobusëve përgjatë rrugës së përcaktuar në rend të udhëtimit

Linjë direkt - linjë në të cilën kryhet transporti ndërmjet stacionit fillestar dhe përfundimtar të autobusëve, përkatësisht të vend ndaljes së autobusëve, e përcaktuar në rend të udhëtimit pa u ndalur nëpër vend ndalje përgjatë rrugës

Transport i veçantë linjor - transportin e vetëm një numri të caktuar të udhëtarëve i cili kryhet në bazë të kontratës me shkrim ndërmjet operatorit të transportit dhe porositësit të transportit, me ç'rast transportin e paguan porositësi

Relacion - distancë ndërmjet dy vendeve të linjës të cilat në rend të udhëtimit janë shënuar si stacione të autobusëve, përkatësisht si vend ndalje të autobusëve

Ndërprerja - çdo periudhe gjate se cilës vozitësi nuk ka drejte vozitjeje apo kryerje te ndonjë detyre tjetër ,e qe i lejon vetëm pushim

Rendi i udhëtimit - akt i cili përmban: emërtimin e operatorit të transportit, linjën në të cilën kryhet transporti, llojin e linjës, radhitjen e stacioneve të autobusëve, përkatësisht të vendaljeve të autobusëve, pastaj distancën nga vendi ku fillon linja, kohën e arritjes dhe të nisjes nga stacioni i autobusëve, përkatësisht në vendndaljet e autobusëve, regjimin e mbajtjes së linjës, periudhën brenda të cilës mbahet linja dhe afatin e vlefshmërisë së rendit të udhëtimit

Aparat i kontrollit - tahografi - aparati i destinuar që të jetë i instaluar brenda automjetit për të regruar dhe regjistruar në mënyrë automatike apo gjysmë automatike të dhënat mbi rrugëtimin e këtyre automjeteve dhe mbi disa, kohën e punës të ngasësve të tyre.

Përgjegjësitë e Komunës

Neni 3

Komuna është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit brenda territorit te saj si vijon:

- a).transportin e rregullt të udhëtarëve;
- b). transportin e lirë të udhëtarëve;
- c). transportin taksi të udhëtarëve;
- d). transportin e udhëtarëve për nevoja vetanake.

Neni 4

4.1. Përcakton politikat e zhvillimit të shërbimeve të transportit rrugor të udhëtarve duke u kujdesur qe keto sherbime të jenë sigurta, efikase dhe ekonomike brenda kufijve administrativë të komunës.

4.2. Harton dhe aprovon planin e transportit rrugor lokal dhe e ndryshon atë sipas nevojës varësisht nga rrethanat e krijuara, i cili nuk duhet të jetë në kundërshtim me rrjetin e linjave ndër-urbane të aprovuar dhe publikuar nga Ministria.

4.3. Ndryshon- azhuron planin e transportit rrugor ne qdo kohë por jo më vonë së pesë vite nga data e nxjerrjes së tij, i cili duhet të jetë në përputhshmëri me politikën e zhvillimit të tërësishëm të transportit rrugor në Kosovë.

4.4. Publikon planin apo planin e ndryshuar dhe një kopje të tij ia dërgon Ministrisë.

Neni 5

5.1. Komuna mund të nxjerr akte administrative përmes të cilave cakton rregullat lidhur me operimin e operatorëve

5.2. rregullimin ose ndalimin e përdorimit të autobusëve publik në rrugë të caktuara ose rajone që kanë lidhje me rrugë;

5.3. marrja dhe zbritja e udhëtarëve dhe çështje tjera lidhur me transportin rrugor të udhëtarëve;

5.4. krijimi dhe mbajtja (ruajtja) e regjistrave dhe inspektimi i tyre;

5.5. transporti i bagazhit të udhëtarëve ose mallrave tjera;

5.6. rregullimin ose ndalimin e transportit të udhëtarëve që qëndrojnë në këmbë;

- 5.7. shpejtësia maksimale e autobusëve publik;
- 5.8. dizajni, pajisja, mjetet (të brendshme ose të jashtme) të autobusëve publik;
- 5.9. pikat e stacioneve dhe vend-ndaljet në linjat për autobus dhe
- 5.10. rregullimin ose ndalimin e shpalljeve, shenjave dhe reklamave brenda apo jashtë autobusëve publik.

Neni 6

Komuna ka kompetencë të certifikojë automjetet me më shumë se tetë plus një (8 + 1) ulëse për transportin urban dhe urbano-periferik

Neni 7

Komuna me akt administrativ përcakton kriteret për dhënien dhe revokimin e licencës për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve në territorin e komunës së saj.

Kushtet për licencimin e operatorëve të transportit të udhëtarëve

Neni 8

Për marrjen e licencës të transportit rrugor të udhëtarë operatori duhet të plotësojë këto kushte:

- a). të jetë i regjistruar (themeluar) në Kosovë;
- b). të ketë reputacion të mirë;
- c). të ketë kapacitete të përshtatshme, qëndrueshme financiare, të cilën e vërteton në bazë të pronësisë mbi mjetet apo garancionet financiare-bankare.
- d). të ketë kompetencën e nevojshme profesionale për menaxher transporti;
- ç). të ketë në gjendje të mirë teknike-eksplotuese automjetet e transportit.

Revokimi i licencës dhe lejes

Neni 9

9.1. Licenca apo leja për veprimtarinë e transportit humbë vlerën kur:

- a). operatori falimenton (nëse vërtetohet me vendim të autoriteteve kompetente);
- b). mbaron afati i vlefshmërisë së saj;
- c). kërkohet nga mbajtësi i saj;

9.2. Licenca apo leja për veprimtarinë e transportit hiqet nga organi që e lëshon atë kur:

- a). vërtetohet se operatori ka humbur njërin nga kushtet e përcaktuar për qasjen në treg të operatorëve të transportit rrugor të përcaktuara në nenin 8 të kësaj rregullore
- b). mbajtësi i licencës apo lejes shkel detyrimet e përcaktuara në këtë rregullore me Ligjin apo aktet nënligjore që e rregullojnë këtë fushë.

9.3. Licenca apo leja për veprimtarinë e transportit i hiqet në mënyrë të përhershme ati operatori që është dënuar nga gjykata kompetente për kryerjen e veprës penale për kontrabandim me narkotik dhe trafikim më qenie njerëzore.

9.4. Propozimin për iniciimin e procedurës për revokimin e licencës dhe lejes sipas paragrafit 9.2 të këtij neni e bënë Inspektorati i komunikacionit.

9.5. Vendimi merret nga organi që e ka lëshuar atë, pas dëshmisë së provave dhe argumentimit nga inspektorët e transportit rrugor.

Neni 10
Transporti i rregullt i udhëtarëve brenda Komunës

Transporti i rregullt i udhëtarëve me autobus brenda territorit të Komunës mund të ushtrohet si:

- a). transport urban dhe urban-periferik;
- b). transport i veçantë i udhëtarëve;
- c). transport për nevoja vetanake.

Neni 11

Transporti urban dhe urban-periferik mund të kryhet si transport i rregullt dhe i njëjti mund të subvencionohet nga Komuna.

Neni 12

Rrjeti i linjave urbane dhe urban-periferike si dhe numri i orareve në të miratohet nga Komuna.

Neni 13

13.1. Transporti urban dhe urban periferik i udhëtarëve në komunën e Deçanit bëhet nga automjetet të cilat i përmbushin kriteret e përcaktuara në Ligjin për Transportin Rrugor dhe me këtë rregullore që nënkupton :

- a). automjetet me mbi 8+ 1 ulëse (autobus).
- b). auto- taksitë me 4+1 ulëse me së paku 4 dyer dhe motoçikleta me 1+1 ulëse

Neni 14

Transporti urban periferik i udhëtarëve në raste të veçanta mund të bëhet nga automjetet me 8+1 ulëse në këto raste:

- a). për transport të veçantë ,duke përfshirë transportimin për nxënësit dhe punëtorët dhe
- b).në rastet kur linja nuk është e mbuluar me autobus

Neni 15

Kur kemi të bëjmë me rastet e përcaktuara si në nenin 14 të kësaj Rregullore, organi komunal në këtë rast Drejtoria për Shërbime Publike si kompetente për lëshimin e lejeve për këta operator duhet të këtë parasysh;

- a). përcaktimin e linjës së udhëtimit për automjetin me 8+1 ulëse
- b).vendnisjen dhe cakun e arritjes , orarin e nisjes dhe anasjelltas
- c). përcaktimin e vendndalesave
- ç).përcaktimin me akt administrativ të vendparkimit për kombi-bustë duke i shmangur stacionet e autobusëve
- d). leja e punës për këta operator jepet për periudhën njëvjeçare.

Neni 16

Drejtoria për shërbime publike në fillim të çdo viti kalendarik bënë ofertë publike për mbulimin e linjave me autobus, në raste se nuk i përgjigjet ofertës asnjë operator i cili i plotëson kushtet , atëherë leja i jepet operatorit të përcaktuar në nenin 14.

Neni 17

Transporti urban dhe urban periferik i udhëtarëve me autobus

17.1. Transporti i rregullt i udhëtarëve me autobusë kryhet në relacione të caktuara (linja) sipas rendit të udhëtimit, të përcaktuar dhe të vërtetuar më parë, çmimit të caktuar të shpallur dhe kushteve të tjera të transportit.

17.2. Linjat të cilat lidhin dy e më tepër vendbanime në territorin e komunës, janë linja komunale.

Neni 18

Drejtoria për Shërbime Publike miraton rrjetin e linjave urbane dhe numrin e orareve.

Neni 19

Komuna mund të lidhë marrëveshje me komunat tjera për rregullimin reciprok të transportit të udhëtarëve. Marrëveshja është e plotfuqishme nëse miratohet nga Ministria

Neni 20

Rendi i udhëtimit është akt me të cilin përcaktohen elementet për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të rregullt në transportin rrugor, në territorin e komunës, i cili përmban:

- a). emrin e transportuesit,
- b). relacionin,
- c). llojin e transportit,
- ç). radhitjen e vend ndaljeve dhe largësinë e tyre nga pika fillestare,
- d). kohën e nisjes dhe kohën e arritjes në çdo stacion dhe vend ndalje,
- e). periudhën kohore në të cilën mbahet linja,
- f). afatin e vlefshmërisë së rendit të udhëtimit.

Neni 21

Rendi i udhëtimit vlen një vit.

Neni 22

Transportuesi është i obliguar që transportin ta kryejë në mënyrë të rregullt dhe sipas rendit të udhëtimit, të vërtetuar dhe të regjistruar.

Neni 23

- a). Transportuesi obligohet që ta fillojë veprimtarinë e transportit të rregullt urban të udhëtarëve në afat prej 3 ditësh nga dita e fuqizimit të rendit të udhëtimit dhe atë nuk mund ta ndërpresë përderisa zgjat afati i rendit të udhëtimit.
- b). Përjashtimisht nga paragrafi a), i këtij neni, transportuesi mund përkohësisht të ndërpresë veprimtarinë, si rezultat i kushteve të jashtëzakonshme të cilat pamundësojnë ushtrimin e veprimtarisë së transportit të rregullt urban.
- c). Për ndërprerjen, nga paragrafi b), i këtij neni, transportuesi është i obliguar që të bëjë kërkesë në Drejtori, e cili do të lëshojë vendim për pranim apo refuzim të kërkesës së transportuesit.

Neni 24

Transportuesi nuk mund ta ndërpresë (pezullojë) veprimtarinë e transportit të rregullt urban në linjë, sipas rendit të udhëtimit të regjistruar dhe të vërtetuar pa lejen e Drejtorisë.

Neni 25

- a). Transportuesi rendin e udhëtimit nuk mund ta tjetërsojë, e as ta japë me qira.
- b). Transferimin e rendit të udhëtimit e bën vetëm Drejtoria.
- c). Emri i transportuesit, i shënuar në rendin e udhëtimit, duhet të jetë i njëjtë me atë të shënuar në librezën e qarkullimit të autobusit dhe në dokumentet tjera përcjellëse të autobusit.

Neni 26

Drejtorja do të revokojë rendin e udhëtimit në kushtet kur:

- a). në afat prej 3 ditësh, nga dita e fuqizimit, nuk e fillon ushtrimin e veprimtarisë;
- b). brenda një muaji kalendarik, pa miratimin e Drejtorisë nuk bën nisjen 3 herë;
- c). bën ndërprerje të kohëpaskohshme të mbajtjes së nisjes, respektivisht kur 12 herë brenda afatit të zgjatjes së rendit të udhëtimit nuk mban nisjen pa miratimin e Drejtorisë.

Neni 27

Linjat dhe nisjet e revokuara do të konsiderohen si të lira dhe të njëjtat i nënshtrohen procedurës për ndarjen e tyre.

Neni 28

Operatori i transportit është i obliguar që ndryshimin e rendit të udhëtimit dhe të drejtimit të transportit, ndaljen e përkohshme apo të përhershme të transportit, paraprakisht të miratuar nga Drejtoria, në linjën e lejuar, ta shpallë përmes shtypit apo një mjeti tjetër të informimit.

Neni 29

a). Transportuesit i propozojnë drejtorisë çmimoren për vërtetimin e çmimit. Çmimoren e miraton Kuvendi i Komunës në kuadër të (rregullores për taksat, tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale). Çmimorja duhet të vendoset në autobusin që qarkullon në atë linjë.

b). Personeli i autobusit merr pagesën për shërbime vetëm në bazë të çmimoreve, nga pika a), e këtij neni.

Neni 30

Transporti me auto taks

a). Drejtuesi i automjetit “taksi” nuk mund të qëndroj dhe as të marr udhëtarë në territorin e komunës në të cilën nuk është i regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë taksi.

b). Transporti “Auto-taksi” zhvillohet brenda territorit të komunës në të cilën është i regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë taksi, transporti “Auto-taksi” mund të kryhet edhe jashtë territorit të komunës, në qoftë se transporti fillon në territorin e komunës në të cilën është i licencuar.

c). Transporti i udhëtarëve me taksi në linjë të rregullt është i ndaluar.

MASAT NDËRSHKUESE

Neni 31

31.1. Për kundërvajtje me gjobë prej 100 deri në 2.500 €, do të dënohet operatori transportues, përkatësisht personi tjetër juridik apo fizik për kundërvajtje, në qoftë se:

a). Ushtron veprimtarinë e transportit publik urban pa licencë;

b). Ushtron veprimtarinë e transportit publik të udhëtarëve pa licencë dhe rend të udhëtimit;

c). Nëse operatori i transportit, përkatësisht personi tjetër juridik apo fizik bën përsëritje të kundërvajtjes së njëjtë, përveç dënimit me gjobë, do t'i shqiptohet edhe masa mbrojtëse e ndalesës së ushtrimit të veprimtarisë së transportit në kohëzgjatje prej 6 deri në 12 muaj.

Neni 32

32.1. Me gjobë prej 100 deri në 2.500 € do të dënohet operatori i transportit, përkatësisht personi tjetër juridik, në qoftë se:

- a). Nuk mban linjën sipas rendit të udhëtimit të vërtetuar dhe të regjistruar;
- b). Ndryshon rendin e udhëtimit, ndërpret përkohësisht transportin dhe nuk e paraqet ndërprerjen;
- c). Nëse nuk përcakton çmimin dhe nuk e vendos atë në autobus apo nuk i përmbahet asaj;
- d). Bën transportin e veçantë të udhëtarëve në kundërshtim me këtë rregullorë;
- e). Bën tjetërsimin e rendit të Udhëtimit apo japë me qira rendin e udhëtimit;

32.2. Për kundërvajtje të njëjta që transportuesi, përkatësisht personi juridik apo fizik i përsërit, përveç dënimit me gjobë, do t'i shqiptohet edhe masa mbrojtëse e ndalesës së ushtrimit të veprimtarisë së transportit, në kohëzgjatje prej 6 deri në 12 muaj.

Neni 33

33.1. Me gjobë prej 150 deri në 300 € do të dënohet operatori i transportit:

- a). Nëse personelit të vozitjes nuk ia siguron rrobat (uniformën) zyrtare;
- b). Për kundërvajtje, nga pika 1 e këtij neni, do të dënohet edhe personi përgjegjës i operatorit të transportit me gjobë prej 75 deri në 120 €.

Neni 34

34.1. Me gjobë prej 150 deri në 200 € do të dënohet për kundërvajtje operatori i transportit:

- a). Nëse kryen transportin me automjete të cilat nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara me këtë rregullorë;
- b). Nëse nuk ia jep biletën e autobusit udhëtarit;
- c). Nëse kryen transportin e personave, të mallrave apo të kafshëve në kundërshtim me këtë rregullorë;

d) Nëse sendet e gjetura në automjet nuk i dorëzon në polici në afatin prej 7 ditësh;

34.2. Për kundërvajtje, nga pika 1 e këtij neni, do të dënohet edhe personi përgjegjës i operatorit të transportit me gjobë prej 50 deri në 100 €.

Neni 35

35.1.Me gjobë mandatore prej 50 € do të dënohet për kundërvajtje udhëheqësi i ekuipazhit të automjetit nëse:

- a) Automjeti nuk ka urdhëresë të udhëtimit të nënshkruar dhe të plotësuar në mënyrë të rregullt;
- b) Nëse nuk ndalet në të gjitha stacionet përkatësisht në të gjitha vendëdaljet.

Neni 36

Dënimet mandatore për kundërvajtje i shqipton inspektori i komunikacionit.

Neni 37

Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare

Për çdo çështje që nuk është trajtuar dhe rregulluar me këtë rregullore implementohen dispozitat ligjore dhe akteve nënligjore që iu nënshtrohet rregullorja si akt juridik.

Neni 38

Për plotësimin ndryshim ose shfuqizimit të kësaj rregulloreje vlejnë procedurat e njëjta si për miratimin e saj

Neni 39

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohen rregulloret e mëparshme që kanë trajtuar këtë lëmi.

Neni 40

Rregullorja hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal

01.Nr.VI-6

Deçan,dt.26.09.2014



Kryesuesi i Kuvendit:
Jashar Dobraj

